Proces-verbal për mbledhjen e radhës të muajit Korrik datë 23-07-2026 ditë e Enjte ora 10⁰⁰ në ambientet e kinemasë.

Kuorumi i mjaftueshëm për fillimin e mbledhjes. Mbledhja shpallet e hapur. Lexohet rendi i ditës nga kryetari i këshillit, që drejton seancën. Miratohet rendi i ditës si më poshtë vijon.

- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23.06.2026
- Projekt-vendim për dhënien e ndihmës ekonomike 6% dhe nga fondet e përbashkëta të akorduara dhe fondet e bashkisë për familjet në nevojë për muajin Qershor 2026
- Projekt-vendim për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" për z. Hasan Korbi
- Projekt-vendim për Miratimin e dhënies me qera të tokës bujqësore, pasuria 108/0, lloji pasurisë "arë", me sipërfaqe 8445 m², me indeks harte kj-34-100-(147-d), Zk. 2539, Luz i vogël, pasuri e regjistruar në ASHK, në përdorim Bashkia Kavajë.
- Projekt-vendim për Miratimin e dhënies me qera të pasurisë me nr. 94/20 vol. 15, faqe 88, lloji pasurisë "pa frut" me sipërfaqe 4544 m², e ndodhur në zonën kadastrale 2099 Karpën, Njësia administrative Golem, pasuri e regjistruar në ASHK, në pronësi të Bashkisë Kavajë.
- Projekt-Vendim për Miratimin e programit të banesave me kosto të ulët për apartamentet e përfituara nga kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave në bashkinë Kavajë.
- Projekt-vendim mbi miratimin e listës së përfituesve nga programi i strehimit "banesa sociale me qera" të apartamenteve të përfituara nga kontributi i sektorit privat.

Hidhet për votim dhe - Miratohet rendi i ditës

Nga kryetari i seancës hidhet për diskutim sipas pikave rendi i ditës. Proces-verbali i mbledhjes paraardhesë është detyrim ligjor. E miratojmë

- Miratohet - procesverbali i mbledhjes së qershorit
- Diskutohet ndihma ekonomike për familjet në nevojë, 6% nga fondet e bashkisë. Anëtarët nuk kanë kundërshti dhe as

diskutim. Kërkohet të kalohet në votim. Hidhet në votim projekt-vendimi për ndihmën ekonomike për familjet në nevojë dhe fondi 6 për nga fondi i bashkisë.
Miratohet P-22 K-0 A-0
Projekt-vendimi për dhënie titulli "Qytetar Nderi" për z. Hasan Korbi
Lexohet motivacioni "Për kontributin e shkëlqyer dhënë në fushën e krijimtarisë si historian dhe poet me krijimtari të jashtëzakonshme artistike, duke botuar libra me vlerë dhe plotësuar kështu një arkiv të vyer letrar e historik për qytetin, për vite dhe dekada. Artist me vlera të gjithanëshme që ka promovuar e ruajtur në kujtesën kolektive emrin e qytetit të Kavajës në mbarë trojet shqiptare".
Këshilltarët shprehen për vlerat që kanë shkrimet e botimet e zotit Korbi, nuk kanë kundërshti. Janë dakord, të vijojnë me votimin
Miratohet P-22 K-0 A-0
Diskutohen dy projekt-vendimet për dhënie me qera të tokës bujqësore pasuria 108/0 llojit "arë" me sipërfaqe 8445 m² në ZK. 2539 në Luz të Vogël dhe dhënie me qera të pasurisë nr 94/20, lloji pasurisë "pafrut" me sipërfaqe 4544 m² në ZK 2099 në Karpen, njësia administrative Golem. Për të dy këto projekt-vendime i kemi sjellë dhe herë tjetër dhe nga Prefektura nuk vjen me verifikim ligjshmërie të konfirmuar pasi është në kundërshtim me ligjin 133/2015 për trajtimin e pronave dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave. Mos na i sillni më derisa të hapet ligjërisht. Këshilltarët janë kundër. Hidhen të dy projekt-vendimet për dhënie toke me qera në votim
Nuk Miratohen - të dy projekt-vendimet derisa të gjendet zgjidhje
Diskutohet për dy projekt vendimet për strehimin social. Argumentohet nga ana e drejtorisë se fondi social mund të përdoret edhe për programet e tjera. Ligji është i përgjithshëm dhe është fugiplotë. Nga anëtarët e këshillit z Habili kërkojmë të dimë sa janë 3%, si janë shpërndarë. Janë mbi 100 leje ndërtimi dhe nuk kemi informacion si janë shpërndarë
Specialisti spjegon se sipas ligjit ka norma detyruese nga urbanistika, ne

na vijnë asetet. Duhet transparencë. Asetet i marrin pasi nënshkruhet marrëveshja me bashkinë, por pasi ka përfunduar objekti. Janë rreth 40 akt marrëveshje aktive - të përfunduara janë shumë pak. Na sillni një tabelë. Malaj - nuk e kanë kaluar kohën e maturimit. Janë pa certifikatë pronësie. Sejes shpjegëzimi janë marrë 3-4, nuk kanë dorëzuar akt marrëveshje. Na e sillni me shkrim. Si dhe për njerëzit që kërkojnë strehim. Të sistemohen ato që kanë më shumë nevojë, më urgjencë. Nuk i miratojmë.
Nuk miratohen të dy projektet për strehimin
Të ndryshme
Paraqitet si shqetësim nga zonja Alia. Taraca e shkollës Rilindja. Shqetësim, tavanet. Janë bërrnuar, çfarë bie jashtë hyn brenda. Kërkohet ndërhyrje urgjente. Znj Qehajaj shtron pyetjen - Objekti është ndërtim i ri. A ka garanci nga ndërtuesi? Kontrolli dhe riparimin kur ka garanci kush e mbulon
- Pyetje nga znja Alia - kur do shpërndahen bursat? Është bërë një kërkesë për transport nga Golemi. Përgjigje - E kemi filluar procesin e tenderit. Shpresojmë ta mbyllim brenda afatit ligjor, po fillu shkolla. Sa për bursat numrat e llogarive kanë gabime. Po rikonfirmohen ato që kanë gabime dhe do të plotësohet procesi në bashkëpunim me ministrinë. Shkollat profesionale nuk janë në varësi të bashkisë. Të gjitha shkollat kanë probleme. Të shikohen të gjitha, por shkolla Rilindja ka disa kërkesa. Kjo shkollë është marrë në dorëzim e pa mbaruar. Janë shtuar fonde. Firmat ndërtuese punojnë keq.
- Pastrimi - firma është katastrofë. Mban erë kudo, është sezon, duhen hequr 2 herë në ditë. Nuk punon vetëm firma, ka edhe mbështetje nga ministria rreth 500 milion. Kryetari ka bërë notë ke ministria që të penalizohen. Plehrat janë problem. Problem tjetër - Hazbie Istrefi është ku thërret kiameti - janë për dhimsë. Të bëjmë një kërkesë kryeministrit për fondet e rindërtimit. Kemi bërë kërkesën, fondi është i miratuar, në buxhet është parashiku, por rezultat. Janë rreth 70 në gjendje kritike. Shkresa bërë në 2022. Të gjendet një zgjidhje qoftë edhe provizore. Miratojmë edhe
[illegible] liste.

Jancelona Dorza
BRUNA GELITI
Orgel Sinille
Rovina Aliej
SHQIPE BALLS A
Suzana Hafuzdiu
Lumy Rushi
Eleuka Shandori
Drefa Visalaca
Eglantina Ajdini
Jetfot Qamera
Melge Kasaze
Albana Hyfine
Andja Leka
Resem Osmani
Ahmet Halili
Denise Dologa
Albana Mustafa
Marinela Alia (Ndihma ekonomike, 6%
Enver Halily
Pyhe Hylin
Qofetar Mak
(Hasan K
Alket Mitrushi